



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjo diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë Lushnje me shkresën nr.11206 prot., datë 10.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.2881/1, ndërtesë private z.Namik Muçaj, pasi pronari i ndërtesës nuk ndodhet në Shqipëri.

Kryetari i Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 11484 prot., datë 13.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.1944/2, ndërtesë private z.Beqir Gjergjndreaj, pasi pronari i ndërtesës nuk pranon që të shërbejë si qendër votimi.

Kryetari i Bashkisë Durrës me shkresën nr. 11483 prot., datë 13.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-ve nr.1372/1, 1372/2, nga ndërtesë private z.Kujtim Dema, pasi pronari i ndërtesës nuk pranon që ndërtesa e tij të shërbejë si qendër votimi.

Kryetari i Bashkisë Elbasan me shkresën nr.11808 prot., nr.11809 prot., datë 17.06.2019, ka kërkuar:



- dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr.2323/3, ndërtesë private zj.Bukuroshe Manaj, pasi pronarja e ndërtesës nuk pranon që ndërtesa e saj të shërbejë si qendër votimi.
- dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr.2352, Kopështi "Fetah Ekmeçiu", pasi Kopështi "Fetah Ekmeçiu" është në rikonstruksion.

Kryetari i Bashkisë Patos me shkresën nr. 11890 prot., datë 19.06.2019, ka kërkuar:

- dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-ve nr.3085, nr.3085/1, Kopështi "Godina e Re", pasi Kopështi "Godina e Re" është në rikonstruksion.
- dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr.3092, Qendra Shëndetësore, pasi Qendra Shëndetësore është amortizuar.

Kryetari i Bashkisë Gramsh me shkresën nr. 11979 prot., datë 20.06.2019., ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.2663, ndërtesë private e z.Mustafa Kotorri, pasi pronari i ndërtesës z. Mustafa Kotorri nuk pranon që ndërtesa e tij të shërbejë si qendër votimi.

KZAZ nr. 27, KZAZ nr. 67, KZAZ nr. 85, në përmbushje të detyrave të tyre, përcaktuar në nenin 33, gërma "a", dhe nenin 56, pika 3, të Kodit Zgjedhor, kanë paraqitur:

KZAZ nr.27, Kamëz, me shkresën nr.11833 prot., datë 17.06.2019 dhe shkresën nr.11909 prot., datë 19.06.2019, referon se pronarët e ndërtesave ku janë caktuar vendodhjet e disa QV, nuk pranojnë të afishohen në to listat e zgjedhësve dhe janë shprehur se nuk do t'i vënë ambientet në pronësi të tyre në dispozicion për Qendra Votimi. Problematikat e evidentuara i janë bërë prezent Kryetarit të Bashkisë Kamëz, përmes nëpunësit ndërlidhës, por nuk ka përgjigje.

KQZ, bazuar në nenin 62, pika 11, të Kodit Zgjedhor, vlerëson problematikat dhe propozimet e referuara për QV si më poshtë:

- QV nr.1564, 1564/1, të miratuara me Vendimin nr.651 datë 26.05.2019 të KQZ-së në ndërtesën private të z.Fiqiri Qinami.
- QV nr.1583, 1583/1, të miratuara me Vendimin nr.651 datë 26.05.2019 të KQZ-së në ndërtesën private të z.Gjovalin Pali.
- QV nr.1588, 1588/1, 1588/2, të miratuara me Vendimin nr.796 datë 03.06.2019 të KQZ-së në ndërtesën private të z.Esat Matranxhi.

KZAZ nr.85, Selenicë, me shkresën nr.11974 prot., datë 20.06.2019, dhe shkresën nr.12004 prot., datë 21.06.2019, referojn problematika të disa ndërtesave, publike apo private, ku janë caktuar vendndodhjet e QV :

- QV nr.4525/1, miratuar me Vendimin nr.106 datë 27.03.2019 të KQZ-së në Ish pallatin e Kultures, pronësi të z. Mihal Çapi, është i amortizuar, pa dyer dhe dritare, duke mos garatuar kushtet e sigurisë.
- QV nr.4527, e caktuar në Shkollën 9-vjecare "Qemal Hoxha", e cila është e amortizuar.
- QV nr.4611, e caktuar në Shkollën 9-vjecare, e cila është e amortizuar.
- QV nr.4608, e caktuar në 9-vjecare "Gumenicë Fushë", e cila është e amortizuar.
- QV nr.4522, e caktuar në Shkollën Filllore Mesarak, e cila është e amortizuar.
- QV nr.4571, e caktuar në Shkollën 9-vjeçare Lepenicë, e cila është e amortizuar.
- QV nr.4559, e caktuar në Shkollën 9-vjeçare Mërtiraj, e cila është e rrënuar.
- QV nr.4556, e caktuar në Shkollën Vezhdanisht, e cila është e amortizuar.
- QV nr.4551, e caktuar në Shkollën 9 vjeçare Mallkeq, e cila është e amortizuar.
- QV nr.4532, e caktuar në lokal privat z.Neim Selami, i cili është totalisht e amortizuar.



- QV nr.4602, e caktuar në Shkollën 9 vjeçare Kote, e cila është në rikonstruksion.

Këto problematika janë referuar edhe nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën me nr.11478 prot., datë 13.06.2019.

KZAZ nr.67, Pogradec, me shkresën nr.11904 prot., datë 19.06.2019, referojnë problematika të dy ndërtesave publike ku janë caktuar vendndodhjet e QV-ve:

- QV nr.3898, 3898/1, 3898/2, të caktuara në Shkollën e Mesme "Muharrem Çollaku", e cila është në rikonstruksion.
- QV nr.3973, 3974, të caktuara në Shkollën 9-vjeçare "Sami Zgjani", e cila është në rikonstruksion.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

